



KUVENDI I KOSOVËS MBAJTI SEANCË SOLEMNE ME RASTIN E 26-VJETORIT TË "EPOPESE SË UÇK-SË"

'EPOPEJA E UÇK-së', TRASHËGIMI E MADHË POLITIKE DHE KOMBËTARE MBI TË CILËN U NDËRTUA SHTETI I KOSOVËS



Kuvendi i Kosovës të martën ka mbajtur seancë solemne me rastin e 26-vjetorit të "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës". Seanca nisi me intonimin e himneve shtetërore dhe kombëtare dhe me një minutë

heshtje për të gjithë të rënë e luftës. Të pranishëm në këtë seancë ishin edhe Rifat Jashari, Bekim Jashari dhe disa anëtarë të tjerë të familjes heroike Jashari nga Prekazi i Skenderajt. Nga zyrtarët e shtetit dhe

përfaqësuesit e opozitës u tha se Jasharët, në krye me Ademin dhe Hamzën, me bacën Shaban e me të gjithë familjarët, gra dhe burra, pleq e fëmijë, u sakrifkuan kolektivisht në luftë të drejtpërdrejtë për liri

AMBASADORËT E HUAJ KËRKOJNË NGA KOSOVA T'I PËRMBUSHË KËRKESAT QË RRJEDHIN NGA PROCESI I DIALOGUT

F. 7



MARRËVESHJA BAZË DHE DINARI SERB, TEMA NË TAKIMIN BISLIMI - LAJÇAK

F. 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



INAUGUROHET OBJEKTI I RI I DEPARTAMENTIT PËR PRODHIMIN E DOKUMENTEVE NË KUADËR TË ARC-së

F. 7

HOXHAJ: SERBIA KA PËR QËLLIM T'I SHNDËRROJË KOMUNAT NË VERI NË PIKËN MË TË TENSIONUAR NË EVROPË

F. 6

HARTOHET DORACAKU I RI PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË LIGJEVE

F. 6

EKONOMI



QEVERIA VENDOS MASA TË REJA MBROJTËSE PËR PRODHIMET E NAFTËS

F. 8

ATK-JA NJOFTON SE VETËM PËR DY MUAJ KA MBLEDHUR 22.5 MILIONË EURO MË SHUMË TË HYRA TATIMORE

F. 3

SPORT



SONTE DY PËRBALLJE NË SUPERLIGË, VËMENDJA TE PRISHTINA - TREPÇA

F. 10

ShBA-ja, zgjedhje paraprake në 16 shtete

UASHINGTON, 5 MARS - Presidenti Joe Biden dhe ish-presidenti Donald Trump ka të ngjarë t'i afrohen marrjes së emërimit nga partitë e tyre për garën presidenciale pas votimeve të sotme paraprake, duke i hapur udhë një përballjeje historike mes tyre, me gjithë rezervat e elektoratit për kandidatët.

Zgjedhjet e Super të Martës po mbahen në 16 shtete dhe një territor, nga Alaska në Kaliforni deri në Vermont dhe Virxhinia. 1/3-ta e delegatëve të partive zgjedhen për votim nga miliona amerikanë sot. Janë delegatët që vendosin për kandidatin presidencial, i cili në zgjedhjet e 5 nëntorit do të garojë në emër të Partisë Republikane apo Demokrate.

Në qendër të zgjedhjeve paraprake janë presidenti demokrat Joe Biden dhe ish-presidenti republikan Donald Trump. Të dy, deri më tani, i kanë zmbursur me lehtësi sfiduesit në votimet paraprake dhe udhëheqin garën brenda partive, pavarësisht se anketimet tregojnë se votuesit nuk duan të shohin më 5 nëntor një përsëritje të garës së 2020-s.

Një anketim i fundit i realizuar nga agjencia e lajmeve Associated Pres dhe Qendra NORC për Hulumtimin e Çështjeve Publike tregon se as Bideni dhe as Trumpi nuk kanë mprehtësinë e nevojshme mendore për ta mbajtur sërish detyrën e presidentit.

Ditët e fundit para Super të Martës dëshmuar se sa ndryshe është fushata presidenciale e këtij viti. Në vend që të bënin tubime në shtetet ku do të mbaheshin votimet paraprake, Bideni dhe Trumpi zhvilluan në të njëjtën kohë, të ndarë, takime përgjatë kufirit ShBA - Meksikë, secili duke kërkuar epërsi në debatin për emigracionin, që është bërë një nga temat kryesore të



fushatës zgjedhore.

Një ditë pasi Gjykata e Lartë vendosi 9-0 që emri i Trumpit të ishte në fletët e votimit, pas përpjekjeve për ta penguar atë që të zgjidhej për shkak të rolit në trazirat e 6 janarit, Trumpi vuri në dukje se 91 akuzat penale ndaj tij janë dëshmi e përdorimit të sistemit të drejtësisë nga Bideni. “Bëje vetë këtë betejë. Mos përdor hetuesit dhe gjykatësit kundër rivalit tënd”, tha Trumpi.

Presidenti Biden pritet ta mbajë të enjten fjalimin kryesor mbi gjendjen e vendit. “Presidenti pritet të përqendrohet te politikat kryesore, hapja e një numri rekord të vendeve të reja të punës, rritja e pagave, forcimi i

ekonomisë, ekonomia më e fortë në botë, ulja e kostove të energjisë dhe ilaçeve me recetë”, tha përmes një deklarate drejtori i Komunikimit në Shtëpinë e Bardhë, Ben LaBolt.

Ish-presidenti Donald Trump ka vetëm një kundërshtare brenda partisë, ish-ambasadoren në Kombet e Bashkuara gjatë administratës së tij, Niki Haley, e cila është zgjedhur dy herë guvernatore në shtetin e saj të lindjes, Karolinën e Jugut.

Deri më tani ajo ka humbur në zgjedhjet paraprake ndaj Trumpit, me përjashtim të fitores në Uashington gjatë fundjavës. Ajo vazhdon të sigurojë mbështetje të fortë nga

donatorët. “Mund të zgjedhim një kandidat për president më të mirë se dy 80-vjeçarë”, tha ajo të hënën gjatë një takimi në qytetin Hjuston në shtetin e Teksasit.

Megjithëse kanë mbizotëruar votimet paraprake në mesin e republikanëve, fitoret e Trumpit kanë treguar dobësi te disa grupe votuesish, veçanërisht në qytete kolegësh si Hanover, Nju-Hamshër, ku gjendet universiteti Dartmouth, ose qyteti Ann Arbor, ku gjendet universiteti i Miçiganit. Votimet kanë sinjalizuar mbështetje të dobët edhe në zonat ku ka përqendrim të madh të votuesve të pavarur.

Presidenti Biden ka problemet e tij, përfshirë mbështetjen e ulët

dhe anketimet që sugjerojnë se shumë amerikanë, madje shumica e demokratëve, nuk duan që një 81-vjeçar të hyjë përsëri në garë.

Fitorja e lehtë e Bidenit në zgjedhjet paraprake në shtetin e Miçiganit u dëmtua në një farë mase nga angazhimi ndër radhët e demokratëve që nuk bien dakord me qëndrimin e presidentit lidhur me luftën e Izraelit në Gazë.

Ata votuan si të “pavendosur” dhe po nxisin që kjo votë proteste të zgjerohet edhe më tej. Një nga shtetet që duhet ndjekur me vëmendje është shteti i Minesotas, që ka një popullsi të madhe myslimane si edhe votues liberalë që nuk janë dashamirës ndaj Bidenit.

Kina njofton planet për 5 % rritje ekonomike

Pekin, 5 mars - Kongresi Kombëtar Popullor i Kinës çeli të martën sesionin vjetor në Pekin. Udhëheqësit kinezë po përqendrohen në zhvillimet pozitive ndonëse vendi po ndeshet me shumë probleme ekonomike.

Në hapjen ceremoniale të punimeve të Kongresit të saj Kombëtar Popullor, Kina njoftoi planet ambicioze për ekonominë. Kjo është një mundësi për të shfaqur optimizëm mes sfidave të shumta ekonomike me të cilat po përballlet vendi.

Kryeministri Li Qiang njoftoi



planet për një rritje ekonomike vjetore prej 5-përqindësh ashtu si në vitin e kaluar. “Arritja e këtyre objektivave këtë vit nuk do të jetë një punë e lehtë. Duhet të jemi të përqendruar në zbatimin e politikave ekonomike dhe duhet t'i dyfishojmë përpjekjet tona nga të gjitha anët”, tha ai. Udhëheqësit kinezë kanë përjetuar një nga rritjet më të ngadalta ekonomike të vendit në disa dekada, ndërsa po përballen me krizën në tregun e pasurive të patundshme dhe ngadalësimin e investimeve të huaja.

Por, në takimin e kontrolluar deri në hollësi, ka optimizëm në

mesin e pjesëmarrësve, ndërsa elita politike e Kinës miraton planet e Partisë Komuniste.

Një nga qëllimet kryesore të këtij takimi është qetësimi i investitorëve të huaj, të cilët kanë shumë pyetje lidhur me gjendjen ekonomike të Kinës. Por, mungesa e konferencave për shtypin mund të mos krijojë mundësinë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve mbi ekonominë e vendit.

Për shumë dekada kryeministri i Kinës u është përgjigjur pyetjeve të gazetarëve në fund të takimit. Këtë vit kjo pjesë e agjendës së takimit është anuluar.

Marrëveshja Bazë dhe dinari serb, tema në takimin Bislimi - Lajçak

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MARS - Çështjet e hapura, veçan Marrëveshja drejt normalizimit dhe ndalimi i dinarit serb, ishin temat e diskutimeve në mes të zëvendëskryeministrit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe të dërguarit të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, më 5 mars në Prishtinë.

Pas takimit, Lajçaku tha se zbatimi i Marrëveshjes Bazë është në interes të të gjithëve, ndërkaq Bislimi, që është kryenegociator i Kosovës në dialogun e Brukselit, sërish fajësoi Serbinë se po refuzon zbatimin e plotë të marrëveshjes. Në takim dy zyrtarët thanë se diskutuan një sërë temash, teksa Bislimi tha se u diskutua edhe për masat ndëshkuese që BE-ja ka vendosur ndaj Kosovës, për mundësitë e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës, për zbatimin e Marrëveshjes për Energjinë - të arritur më herët në dialog - për çështjen e targave, telekomunikacionit dhe

pasaportave që Serbia lëshon për serbët në Kosovë.

Pas takimit në Qeverinë e Kosovës, Lajçaku tha për mediet se çështja më e rëndësishme e diskutimeve ishte ajo e zbatimit të Marrëveshjes Bazë. “Kemi një listë të gjatë të çështjeve për të cilat kemi diskutuar, por më e rëndësishmja është zbatimi i Marrëveshjes Bazë. Është në interesin e të gjithëve që të shohim përparim më të shpejtë në këtë drejtim”, tha Lajçaku për gazetarët në Prishtinë.

Sipas emisarit evropian, Marrëveshja Bazë - që u arrit në Bruksel shkurtin e kaluar, më pas në mars në Ohër u arrit pajtimi për Aneksin e saj - është ligjërish e obligueshme, pavarësisht se palët nuk e kanë nënshkruar. “Kjo marrëveshje është marrëveshja më e mirë që mund të siguronin Kosova dhe Serbia. Jam shumë i sigurt për këtë. Nëse do të kishte marrëveshje më të mirë, ajo veçse do të ishte propozuar. Prandaj, është në interesin e të gjithëve që ta nisin zbatimin e saj. Me këtë marrëveshje ne kemi përgjigje në pyetjet se si, çfarë të bëjmë dhe kur

ta bëjmë. E vetmja pyetje që mbetet është se kur dhe unë pyes: Pse të presim? Kjo marrëveshje është e mirë dhe duhet të nisë së zbatuari”, tha ai.

Marrëveshja prej 11 nenesh në rrugën drejt normalizimit, ndër të tjera, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

Ndërkaq zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, përmes një njoftimi për medie, tha se nënshkrimi i Marrëveshjes Bazë do të ishte garanci për pranimin dhe zbatimin e saj. “Zëvendëskryeministri Bislimi ritheksoi se marrëveshja duhet të zbatohet përmes një plani të sekuencimit të drejtë, të barabartë e të balancuar mes palëve. Ai tha se nënshkrimi i marrëveshjes është garanci për pranim dhe zbatim të saj”, u tha në njoftim.

Para gazetarëve Lajçaku foli edhe për çështjen e dinarit serb, duke

pranuar se për një gjë të tillë kishte organizuar më 27 shkurt një takim në Bruksel në nivel ekspertësh. Megjithatë, ai tha se disa aspekte të rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës është dashur të diskutohen me Bislimin. “E di që kemi pasur takim javën e kaluar në nivel ekspertësh në Bruksel. Takimi ishte konstruktiv dhe arritëm të gjenim përgjigje për disa pyetje. Por, janë disa pyetje që shkojnë përtej mandatit të këtyre ekspertëve dhe i kemi diskutuar këto çështje me Bislimin. Komunikimi ynë do të vazhdojë dhe planifikoj të organizoj një takim të ri në ditët në vijim në nivel të kryenegociatorëve”, sqaroi Lajçaku.

Lidhur me këtë temë, sipas njoftimit të lëshuar nga Zyra e Bislimit, u përsërit qëndrimi i Qeverisë së Kosovës se rregullorja e BQK-së nuk është pjesë e negociatave në Bruksel. “Qeveria e Kosovës është e interesuar ta sigurojë vazhdimësinë e mbështetjes financiare të Serbisë për serbët e Kosovës në fushën e edukimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale”, u tha në njoftim.

Në takimin e 27 shkurtit në Bruksel, të thirrur për çështjen e dinarit serb, Kosova u përfaqësua nga krerë të Bankës Qendrore të Kosovës, ndërkaq Serbia nga kryenegociatori i saj, Petar Petković. Lajçaku, duke folur për mospjesëmarrjen e Bislimit në këtë takim, tha se “qëllimisht”, në ftesën dërguar palëve, e kishte lënë të hapur mundësinë që ato të zgjidhnin se kush do t'i përfaqësonte në takim.

Rregullorja e BQK-së, që parasheh vetëm euron valutë me të cilën mund të kryhen pagesat me para të gatshme, ka hyrë në fuqi më 1 shkurt.

Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre në dinarë - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

Rregullorja është kritikuar nga BE-ja dhe Shtetet e Bashkuara. Uashingtoni ka kërkuar që Kosova ta shtyjë zbatimin e vendimit, duke argumentuar se ai u mor pa konsultime paraprake dhe pa marrë për bazë ndikimet te popullata serbe.



ATK-ja njofton se vetëm për dy muaj ka mbledhur 22.5 milionë euro më shumë të hyra tatimore

PRISHTINË, 5 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ka shënuar një performancë jashtëzakonisht të mirë në inkasimin e 172 milionë euro të hyra tatimore për periudhën janar - shkurt 2024. “Me një angazhim të vazhdueshëm për të

avancuar dhe për të siguruar efikasitet në administrimin e detyrave tatimore, ATK-ja ka arritur rezultate të shkëlqyera edhe në këtë fillimit”, ka njoftuar ATK-ja. Gjatë periudhës janar - shkurt 2024 ATK-ja ka realizuar inkasim të konsiderueshëm të të hyrave

tatimore. Në krahasim me vitin e kaluar, ka rritje për 15 %, ndërsa në raport me planin tejkallim, 7.8 milionë euro apo 4.7 %, duke demonstruar angazhimin e vazhdueshëm për zbatimin e ligjit dhe për të ndërtuar një ambient të favorshëm për bizneset dhe qytetarët.

Përmirësimi i efikasitetit dhe transparencës në procesin e inkasimit është një prioritet i autoritetit tatimor dhe ky rezultat reflekton në realizimin e qëllimeve strategjike. “ATK-ja vazhdon të angazhohet për përmirësimin e klimës së biznesit dhe të kushteve të favorshme për zhvillimin

ekonomik të Kosovës. Performanca e jashtëzakonshme e ATK-së në muajin shkurt është një dëshmi e qartë e përkushtimit për t'i përbushur detyrat e saj në mënyrë të përgjegjshme dhe të efektshme”, ka njoftuar ATK-ja.



KUVENDI I KOSOVËS MBAJTI SEANCË SOLEMNE ME RASTIN E 26-VJETORIT TË “EPOPESE SË UÇK-SË”

‘Epopeja e UÇK-së’, trashëgimi e madhe politike dhe kombëtare mbi të cilën u ndërtua shteti i Kosovës

Kuvendi i Kosovës të martën ka mbajtur seancë solemne me rastin e 26-vjetorit të “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”. Seanca nisi me intonimin e himneve shtetërore dhe kombëtare dhe me një minutë heshtje për të gjithë të rënët e luftës. Të pranishëm në këtë seancë ishin edhe Rifat Jashari, Bekim Jashari dhe disa anëtarë të tjerë të familjes heroike Jashari nga Prekazi i Skenderajt. Nga zyrtarët e shtetit dhe përfaqësuesit e opozitës u tha se Jasharët, në krye me Ademin dhe Hamzën, me bacën Shaban e me të gjithë familjarët, gra dhe burra, pleq e fëmijë, u sakrifkuan kolektivisht në luftë të drejtpërdrejtë për liri



drejtpërdrejtë për liri.
Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në fjalën e tij në

këtë seancë solemne ka thënë se për kombet në botë më e rëndësishmja është liria, duke theksuar se sakrificat madhështore e Jasharëve na ka ngritur kombëtarisht në nivelin më të lartë të dinjitetit dhe të krenarisë. “Jasharët, në krye me Ademin e Hamzën, me bacën Shaban e të gjithë familjarët, gra e burra, pleq e fëmijë, u sakrifkuan kolektivisht në luftë të drejtpërdrejtë për liri. Ata kolektivisht e zbatuan parimin ideal të jetës - Liri a Vdekje! Kur kombi arrin ta përcaktojë këtë princip rënia bëhet liri e liria bëhet domosdoshmëri. Liria është si ajri, por ajo nuk rri pezull. Ajo ngrihet mbi themele të forta. Kurse rrënjët e saj shtrihen thellë në tokën e të parëve tanë. Siç thoshte Hamza - ne do të jemi këtu, sepse nuk kemi ku të shkojmë: guri peshon në tokën e vet”, ka thënë ai, duke shtuar se themelet e lirisë sonë rrinë të patundura mbi gjakun e dëshmorëve. “Rënia heroike e Jasharëve i dha jetë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kurse Ushtria e Kosovës, e njësuar me popullin, e çliroi atdheun tonë

nga Serbia. Pavarësia e shtetit tonë është rezultat i këtij procesi. Nuk e di kurrë se a janë fjalët të afta ta thonë krejt ngjarjen. Nuk e dimë kurrë se a mund ta kuptojmë plotësisht përmasën e kësaj sakrifice. Druaj nëse vërtet mund t'i dalim hakut në të gjallët heroizmit të tyre. Por një gjë të thjeshtë me siguri e di sa është i sigurt edhe gjaku i tyre - se sa të ketë komb shqiptar mbi dhe, secili do të vijë në Prekaz e do të frymëzohet, aty ku u ngjiz liria. Lavdi Jasharëve! Zoti e bekoftë kombin tonë të pamposhtur!”, ka thënë Konjufca.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, në fjalimin e saj tha se epopeja e UÇK-së përcaktoi fatin tonë si popull dhe shtet, duke shtuar se ka qenë epope e dinjitetit, krenarisë dhe lirisë. “Sa herë vjen marsi kujtimet tona natyrshëm na kthejnë në periudhën më të lavdishme të historisë sonë që lidhet me përpjekjet tona për liri dhe shtet. Sërish vjen marsi nuk është vetëm këngë, është moto e kujtesës dhe nderimit të luftës për liri e cila identifikohet me komandantin legjendar Adem Jashari, familjen e tij dhe gjithë ushtrinë çlirimtare”, është shprehur ajo. Osmani pohoi tutje se “Adem Jashari dhe familja e tij refuzuan të përkulen, ndaj luftuan për dinjitet dhe lirinë e gjithë Kosovës”. “Kryengritës Adem Jashari ra në altarin e lirisë bashkë me familjen e tij, duke u shndërruar kështu në gardian të përhershëm të Kosovës”, ka deklaruar Osmani.

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se çdo vit më 5 apo 6 mars, si për asnjë tjetër rast dhe si për asnjë tjetër figurë, Kuvendi i Kosovës mbledhet në seancë të veçantë për ta kujtuar betejën e rezistencës e flijimin e Adem Jasharit dhe të familjes së tij në Prekaz më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998. Ai ka thënë se shumë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 5 MARS - Kuvendi i Republikës së Kosovës, në kuadër të programit të manifestimit shtetëror për shënimin e 26-vjetorit të “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, mbajti të martën seancë solemne. Seanca nisi me intonimin e himneve shtetërore dhe kombëtare dhe me një minutë heshtje për të gjithë të rënët e luftës. Këtë herë dy këngëtarët e njohur, Shkurte Fejza dhe Ilir Shaqiri, u

paraqitën para deputetëve me rastin e përvjetorit të “Epopesë së UÇK-së” dhe kënduan nga një këngë.

Të pranishëm në këtë seancë ishin edhe Rifat Jashari, Bekim Jashari dhe disa anëtarë të tjerë të familjes heroike Jashari nga Prekazi i Skenderajt.

Nga zyrtarët e shtetit dhe përfaqësuesit e opozitës u tha se Jasharët, në krye me Ademin dhe Hamzën, me bacën Shaban e me të gjithë familjarët, gra e burra, pleq e fëmijë, u sakrifkuan kolektivisht në luftë të





ngjarje me rëndësi historike pasohen nga tradita të themeluara për kujtim dhe nderim të tyre, por vetëm ato që kanë përmbajtje të vërtetë burimore dhe potencial shpërthyes, arrijnë të kthehen në tradita të mirëfillta kombëtare ndër breza. “Në rastin e qëndresës së Jasharëve të Prekazit kjo provë është kaluar suksesshëm qysh para 25 vitesh, kur në njëvjetorin e kësaj qëndrese, më 6 mars të vitit 1999, Trupa Artistike ‘Hamëz Jashari’ e UÇK-së e ideoi shënimin e parë të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kështu, manifestimi që ka nisur qysh në mars të vitit 1999, nën zjarrin e luftës, në njëvjetorin e luftimeve në Prekaz dhe ku e mori emrin ‘Epopeja e UÇK-së’, ndër vite ka zënë vend brenda institucioneve të Republikës së Kosovës, deri sot kur po e shënojmë 26-vjetorin e saj. ‘Epopeja e UÇK-së’, përkatësisht historia e luftës së armatosur e Adem Jasharit, e familjes Jashari të Prekazit dhe të gjithë atyre që ecën bashkë me ta dhe pas tyre në rrugën e çlirimit, përmbledhin një trashëgimi të madhe politike, kulturore dhe kombëtare, nga e cila ka ardhur liria e Kosovës dhe mbi të cilën është ndërtuar edhe vetë shteti i saj”, ka thënë Kurti, duke shtuar se Kosova është çliruar prej Serbisë okupatore, pikërisht nëpërmjet trashëgimisë politike që e prodhoi personalitetin dhe figurën e Adem Jasharit. “Nga po kjo trashëgimi është ngritur dhe po ndërtohet dhe po forcohet edhe shteti ynë. E kam fjalën për trashëgiminë e dalë

nga kultura e rezistencës së armatosur dhe e aktivizmit të kulluar politik, sidomos që nga Lidhja e Prizrenit e këtej, që i ka karakterizuar shqiptarët dhe veçanërisht Kosovën. Sepse vërtet rezistenca e Jasharëve të Prekazit është unike në vetvete, por ajo nuk është pa referenca në historinë e shqiptarëve, siç nuk është e patrasueshme edhe më tutje, madje edhe sot”, është shprehur Kurti. Kryeministri ka theksuar se në histori të çlirimit dhe të shtendërtimit, Adem Jashari dhe krejt çfarë përfaqëson figura e tij, ka një hisë shumë të madhe, që në të vërtetë është hisja më e madhe që mund ta ketë një njeri në historinë e vendit dhe të kombit të tij. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, me rastin e shënimit të përvjetorit të “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka kujtuar sakrificën e familjes Jashari. “Më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, në Prekaz të Drenicës, fjalët qëndresë, sakrificë, guxim e krenari, morën kuptimin e vërtetë. Ato u përbashkuan në një vend, në një familje dhe në një mbiemër: familja Jashari! Heroizmi dhe sakrifica e familjes Jashari mishëron shpirtin e një kombi të etur për liri. Secili anëtar i familjes Jashari u bë fanar shprese në luftën e përgjakshme për çlirim. Nga baca Shaban e te nana Zahide, nga Hamza e te Blerina, nga Ademi e te Kushtrimi 13-vjeçar, pushka e të cilit shkrepri e fundit në atë betejë”, ka thënë Krasniqi.

Në 26-vjetorin e “Epopesë së UÇK-së”, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, përkujtoi sakrificën sublime të familjes Jashari. “Datat 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 shënojnë ngjarjen më kulminante në luftën e Kosovës për liri e çlirim; sakrificën sublime të familjes

gëzojmë sot”, është thënë njoftimin e LDK-së. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj dhe ai i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, kanë bërë të martën homazhe në Prekaz. “Shtëpia e Jasharëve u bë një simbol i luftës për liri, një

shënimin e 26-vjetorit të “Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” u mbajt edhe ceremonia e rreshtimit të kuadrateve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Kazermën “Adem Jashari”.

Lulzim Jashari: Arma e shqiptarit shkrep vetëm në emër të lirisë

Lulzim Jashari, djali i komandantit Adem Jashari, tha se arma e shqiptarit u shkrep vetëm për lirinë. Në fjalimin e mbajtur në ceremoninë që është mbajtur në Kazermën Ushtarake “Adem Jashari” në Prishtinë, ai tha se nëntori dhe marsi janë muajt kur më shumë se herët e tjera kthejnë vështrimin mbi historinë tonë. “Nëntori dhe marsi janë muajt kur më shumë se herët e tjera kthejnë vështrimin mbi historinë tonë. Të dashur ushtarë, ju që keni traditë të pasur luftëtarësh që nga Skënderbeu, Lidhja e Prizrenit, e UÇK-së, duhet të jeni krenarë. Armët tuaja janë vazhdimësi e armëve më të pastra në Ballkan dhe më gjerë. Armët e paraardhësve nuk u ndotën kurrë me gjakun e civilëve, ato shënjestruan vetëm uniformën e pushtuesve. Arma e shqiptarit shkrep vetëm në emër të lirisë. Këtë traditë madhështore duhet ta ruajmë dhe t’ua trashëgojmë brezave”, ka theksuar Jashari.



Jashari e me këtë dhe fillimin e fundit të përpjekjes sonë shekullore për liri”, thuhet në njoftimin e LDK-së. Më tej në deklaratë thuhet se rënia heroike e familjes Jashari ishte kushtrim për një popull të tërë. “Ishte kampanë për luftën dhe përpjekjen tonë kolektive drejt lirisë, e për aleancat e ardhshme që do të rreshtoheshin me idealin e tyre e tonin pa dallim. Sot, në këtë 26-vjetor të ‘Epopesë së UÇK-së’, ne i kujtojmë me nder e krenari fëmijët, gratë dhe burrat më të mirë të kombit që sakrifkuan jetën për lirinë dhe shtetin që e

fortifikim i vendosur kundër shtypjes dhe okupimit. Nëpërmjet guximit dhe vendosmërisë së tyre ata u bënë një shembull për gjithë kombin tonë, duke treguar se edhe nën shtypjen më të rëndë, rezistenca është e mundur dhe se fitorja ndaj armikut është e arritshme. Familja heroike Jashari, udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, nuk u përl para shtypjes dhe okupimit, por zgjodhi të qëndrojë drejt për lirinë e vet dhe të gjithë kombit”, ka thënë Haradinaj. Në kuadër të programit të manifestimit shtetëror për



Arrestohet një zyrtar për keqpërdorim të detyrës

Prishtinë, 5 mars - Një zyrtar i gjendjes civile është arrestuar nën dyshimin se ua kishte mundësuar disa personave ta fitonin nënshkrimin e Kosovës në mënyrë të jashtëligjshme gjatë vitit të kaluar në komunën e Mamushës, në jug të Kosovës, njoftoi Policia e Kosovës të martën. Ai dyshohet se ua ka dhënë nënshkrimin e

Kosovës, në kundërshtim me ligjin, gjashtë personave. Sipas njoftimit, Njësia Rajonale për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Korrupsionit në Prizren kishte pranuar një informatë në janar 2024 për dyshimet se zyrtarë të gjendjes civile në Mamushë ishin përfshirë në veprën penale “keqpërdorim i pozitës ose autoritetit zyrtar”.

“Me autorizim dhe udhëzime nga prokurori i çështjes janë siguruar dëshmi relevante. Kështu, është krijuar dyshimi i arsyeshëm se i dyshuari-zyrtar i gjendjes civile në Mamushë, gjatë vitit 2023 ka regjistruar në sistemin e gjendjes civile gjashtë persona në kundërshtim me ligjin”, thuhet në njoftim. I dyshuari besohet se i ka

ndihmuar personat në fjalë të regjistrohen në regjistrin civil të Kosovës, pastaj ta fitojnë shtetësinë e Kosovës pa qenë fare të pranishëm në Kosovë gjatë procesit. “Vetëm për një person është gjetur dosja, të cilin e ka regjistruar me datë 05.05.2023, ndërsa për personat e tjerë dosjet e tyre nuk ekzistojnë fare”, sipas njoftimit.



I dyshuari është dërguar në paraburgim për 48 orë me urdhër të prokurorit, pasi ishte marrë në pyetje në praninë e avokatit mbrojtës, njoftoi policia.

Hoxhaj: Serbia ka për qëllim t'i shndërrojë komunat në veri në pikën më të tensionuar në Evropë

Prishtinë, 5 mars - Ish-ministri i Punëve të Jashtme i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka marrë pjesë në konferencën “Urëzimi i Ballkanit Perëndimor: diplomacia

parlamentare për sigurinë rajonale dhe integrimin euroatlantik”, që është organizuar nga Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë i Kuvendit të Kosovës, me mbështetje të organizatës “Friedrich Ebert Stiftung” në Prishtinë.

Hoxhaj në këtë konferencë foli për diplomacinë e mbrojtjes, me fokus mbi sfidat e sigurisë rajonale në promovimin e stabilitetit dhe ndërtimit të paqes. “Sot kemi hyrë përfundimisht në një kohë kur mendimet tona formësohen nga lufta, paqja dhe siguria si asnjëherë

më parë! Nëse lufta në Ukrainë para dy vitesh dhe lufta në Gaza vitin e kaluar ndikuan mbi perceptimin tonë, këtë vit ndonjë agresion rus ndaj Moldavisë edhe më shumë do ta mbajë gjallë temën e luftës në mendjen tonë! Kërcënimet në Evropën Lindore mund të barten shpesh në Ballkan, por kërcënimet e sigurisë së Kosovës e kanë burimin në Serbi, me mbështetje gjeopolitike të Rusisë!”, ka theksuar Hoxhaj, duke përmendur tri shqetësime që kanë të bëjnë me Kosovën dhe rajonin. “Së pari, dhuna në veri, akti i agresionit në Banjskë dhe situata e tanishme tregojnë që Serbia ka për qëllim t'i shndërrojë komunat në veri të Kosovës në pikën më nervlagjike, më të tensionuar të



sigurisë në Evropë, jashtë Ukrainës!”, ka deklaruar Hoxhaj. Ai ka theksuar se e sheh kyçe në veri të vendit rikthimin e procesit politik me zgjedhje, me

pjesëmarrje të komunitetit serb në institucionet e policisë, sundimit të ligjit dhe gjyqësisë. “Sot është një vakum institucional, qoftë në raport të

popullatës serbe me komunat në veri dhe vakum institucional të raportit të serbëve lokalë me qeverinë dhe institucionet qendrore! Së dyti, dialogun me Serbinë e shoh të rëndësishëm jo vetëm për normalizim të raporteve ndërshtetërore, por edhe për sigurinë rajonale, e cila mund të arrihet vetëm përmes një marrëveshjeje jobazike, por gjithëpërfshirëse, me njohje të ndërsjellë si marrëveshje finale! Së treti, duhet patjetër të përmbyllet shtet-ndërtimi i Kosovës dhe pa ndodhur kjo, si parakusht bazë i sigurisë, prioriteti më i lartë i Kosovës dhe partnerëve tanë duhet të jetë anëtarësimi në NATO”, ka theksuar Hoxhaj.

Kurti bën thirrje për armëpushim të menjëhershëm në Gazë

PRISHTINË, 5 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u është bashkuar udhëheqësve të tjerë botërorë, duke bërë thirrje për një armëpushim të menjëhershëm në luftën në mes të Izraelit dhe Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian.

Thirrja e Kurtit vjen një ditë pasi nënpresidetja amerikane, Kamala Harris, kërkoi që Izraeli dhe Hamasi të arrinin një armëpushim dhe që Izraeli të gjente mënyra që do të mundësonin dërgimin e më shumë ndihmave në Rripin e Gazës. “I bashkohem



nënpresidentes amerikane Kamala Harris, edhe udhëheqësve të tjerë botërorë, në thirrjen për

armëpushim të menjëhershëm në Gazë, për lirin e pengjeve dhe për rritjen e ndihmës

humanitare. Vdekjet e civilëve dhe vuajtjet në këto muaj që nga sulmi terrorist i Hamasit janë një thirrje urgjente për veprim të menjëhershëm dhe vendimtar”, ka shkruar Kurti në “X”.

Lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit nisi më 7 tetor, pas sulmit vdekjeprurës të kryer nga ekstremistët palestinezë në jug të Izraelit, ku vranë 1 200 persona dhe rrëmbyen 250 të tjerë.

Izraeli u kundërpërgjigj me një ofensivë tokësore dhe ajrore, që deri më tani ka lënë të vrarë mbi 30 000 persona në Gazën prej 2.3 milionë banorësh.

Pas nisjes së luftës, Kurti kishte shprehur shqetësim për, siç kishte

thënë, krimet kundër civilëve nga Hamasi në Izrael.

Numri dy i ShBA-së, shtetit aleat të Izraelit, po ashtu tha një ditë më herët se njerëz të pafajshëm në Rripin e Gazës po përjetojnë një “katastrofë humanitare”.

Uashingtoni ka insistuar që një armëpushim të hyjë në fuqi në nisje të Ramazanit, që fillon javën e ardhshme.

Një armëpushim i tillë do të zgjaste gjashtë javë, pas një armëpushimi më të shkurtër prej një jave të arritur në nëntor. Dhjetëra pengje që mbahen nga Hamasi do të lroheshin në këmbim të qindra të burgosurve palestinezë që gjenden në burgjet izraelite.

Hartohet doracaku i ri për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve

Prishtinë, 5 mars - Administrata e Kuvendit të Kosovës, me mbështetjen e NDI dhe USAID, ka hartuar doracakun për shqyrtimin post-legjislativ në Kuvendin e Kosovës.

Qëllimi i këtij doracaku është të sqarojë në detaje procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve nga ana e komisioneve parlamentare. Doracaku bën zëbrthimin praktik të Nenit 99 të Rregullores së Kuvendit, i cili

rregullon mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe vendimeve si dhe neneve të tjera të Rregullores së Kuvendit dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Doracaku është përgatitur ekskluzivisht për deputetët dhe administratën e Kuvendit, për ta lehtësuar ushtrimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit.

Hartimi dhe publikimi i doracaktut vjen pas një pune

intensive të nisur në vitin 2023 nën udhëheqjen e ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtarë dhe administratës së Kuvendit, dhe është i bazuar mbi legjislacionin në fuqi dhe praktikën më të mira legjislative të demokracive parlamentare. Doracaku është hartuar në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e partnerëve të Kuvendit, NDI Kosovo dhe USAID Kosovo.



Ambasadorët e huaj kërkojnë nga Kosova t'i përmbushë kërkesat që rrjedhin nga procesi i dialogut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MARS - Nën fasilitimin e kryetarit të Këshillit për Qeverisje Gjithëpërfshirëse, Alex Roinishvili Grigorev, konferenca "Urëzimi i Ballkanit Perëndimor: diplomacia parlamentare për sigurinë rajonale dhe integritimin euro-atlantik", ka vazhduar punimet me sesionin e fundit "Përshkrimi i së ardhmes: drejtimet e politikave dhe angazhimi diplomatik".

Duke i inkurajuar panelistët të jenë sa më konstruktivë përgjatë këtij sesioni, Grigorev tha se ky panel është mundësi e jashtëzakonshme që të dëgjojmë nga afër për sfidat që po e prekin Ballkanin Perëndimor si dhe instrumentet dhe mekanizmat potencialë për t'i ballafaquar ato, duke u rithirrur gjithmonë në politikat e përbashkëta.

Për t'i dhënë pikëpamjet e tyre lidhur me drejtimet e ardhshme të politikave, angazhimin diplomatik, vendosjen e një udhërrëfyesi për bashkëpunim të vazhdueshëm në BB dhe shqyrtimin e ndryshimit të dinamikave të politikës dhe sigurisë globale, pjesë e këtij paneli ishin: Donika Gërvalla, ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Jeffrey Hovenier, ambasador i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Thomas Szunyog, shef i Zyrës së BE-së në Kosovë si dhe Jorn Rohde, ambasador i Gjermanisë në Kosovë.

Ministria Gërvalla në fjalën e saj drejtuar të pranishmëve u shpreh se mësimi më i mirë që ka marrë

përgjatë tri viteve të qeverisjes është se jo çdoherë e njëjta rrugë e gavrur na çon drejt qëllimeve tona. Sipas saj, perspektiva dhe aplikimi i rrugëve të ndryshme, por pa ndryshuar për asnjëherë të vetëm qëllimin kryesor të vendit tonë, që është Perëndimi - anëtarësimi në BE dhe NATO.

Gërvalla, referuar dialogut Kosovë - Serbi, u shpreh se, fatkeqësisht, çështja e dialogut nuk prodhon ndonjë rezultat pozitiv sepse, sipas saj, dialogu parimisht duhet të zhvillohet mes dy palëve, në këtë rast mes Kosovës dhe Serbisë, por që kjo e fundit vetëm e proklamoi dialogun, kur në të vërtetë angazhohet vetëm për sulm dhe konflikt. "Dialogu si i vetëm nuk mund të sjellë gjithmonë sukses. Në kohë lufte, të kesh sukses në dialog, të duhen mbrojtja, diplomacia dhe vendimet. BE-së i është dhënë një dokument nga kryeministria e Serbisë, ku thuhet se ata nuk ndihen të obliguar nga rezultatet e dialogut nga viti i shkuar. Nëse shkohet një hap para dhe dy prapa, atëherë pyetja është a do të kthehemi në të '90-at?", tha Gërvalla.

Në anën tjetër, ambasadori Hovenier ka theksuar se Kosova duhet të tregojë vullnet të vazhdueshëm dhe kreativitet në dialogun me Serbinë në mënyrë që vendit t'i hapet rruga për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Sipas tij, kjo arrihet vetëm përmes dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja pasi, siç u shpreh ai, bashkësia ndërkombëtare dëshiron ta shohë Kosovën të avancojë në rrugën e saj drejt Perëndimit.



Kërkesën për dialog, si rrugë e vetme kjo për ta çuar Kosovën drejt anëtarësimit në BE dhe NATO, e përkrahu edhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Thomas Szunyog, si dhe ambasadori i Gjermanisë, John Rohde. Ky i fundit shtoi se Kosova duhet t'i përmbushë kërkesat që rrjedhin nga procesi i dialogut. Sepse, sipas tij, kjo e afron Kosovën për anëtarësim në BE dhe në Këshillin e Evropës. Panelistët dhanë edhe pikëpamjet e tyre lidhur me të ardhmen e Kosovës dhe rajonit, me ç'rast diskutuan edhe rreth luftës në Ukrainë dhe mundësinë e zgjerimit të Bashkimit Evropian, si dhe probabilitetin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin Evropian dhe NATO.

Në fund të panelit, përmes një videoje, të pranishmëve iu drejtua deputeti ukrainas Oleksiy Goncharenko, i cili ritheksoi se përmes diplomacisë parlamentare mund të krijohen ura bashkëpunimi dhe mund të parandalohen skenarë me rrezikshmëri për rajonin dhe Evropën. Po në mesazhin e tij deputeti Goncharenko u shpreh se fuqishëm mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshill të Evropës dhe se është duke lobuar për njohje të Kosovës nga shteti që ai përfaqëson. Për t'i dhënë konkluzionet e kësaj konference, kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, njëherësh nikoqire, Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, duke falënderuar secilin

prej panelistëve, u shpreh se është thelbësore që përpjekjet tona të plotësohen me mbështetje dhe angazhim të shtuar nga partnerët tanë, duke njohur kështu rrugën e sinqertë dhe të zellshme që Kosova ka zgjedhur drejt reformës dhe integritimit. Sipas saj, rruga e integritimit nuk duhet të pengohet nga konsideratat politike të shteteve individuale të rajonit. Në fund, kryetarja Kryeziu-Hyseni ka thënë se ashtu siç na ka bashkuar fryma e bashkëpunimit përgjatë kësaj konference, të bashkuar të ecim edhe drejt sfidave që na presin, duke realizuar kështu një vizion të një Ballkani Perëndimor të integruar plotësisht në familjen euroatlantike.

Inaugurohet objekti i ri i Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve në kuadër të ARC-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë të martën në inaugurimin e objektit të ri të Departamentit për Prodhimin e Dokumenteve, në kuadër të Agjencisë për Regjistrimin Civil, ceremoni në të cilën ishte bashkë me ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, dy zëvendësministrit, Bardhyl Dobra dhe Blerim Gashani, dhe drejtorin e Agjencisë së Regjistrimit Civil të Republikës së Kosovës, Blerim Camaj.

Me vizitën dhe përrurimin e objektit të ri për prodhimin e pasaportave në Republikën e Kosovës, kryeministri Kurti theksoi se tashmë kushtet e punës për secilin zyrtar publik për këtë çështje që kërkon integritet të lartë personal dhe



profesional janë shumë më të përshtatshme e të dinjitetshme. "Vlera e

gjithëmbarshe e këtij objekti në punimet që janë kryer tashmë është 1.5 milion euro.

Gjithsej janë 196 zyrtarë në aplikimin për pasaporta në Republikën e Kosovës, prej tyre

janë 20 në Prishtinë, ndërsa 95 zyrtarë i kemi te sektori për prodhimin e pasaportave, të cilët tash i kanë kushtet për punë të dinjitetshme, të përshtatshme. Nga ky takim e vizitë që patëm, ishte e qartë që zelli për punë është shtuar, por edhe falënderimi i tyre për këto zyra të reja, në të cilat ata ndodhen tani", u shpreh kryeministri.

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, duke i falënderuar qytetarët për mirëkuptimin që patën ditët e fundit për shkak të bartjes së institucionit dhe për vonesat në ofrimin e shërbimeve, njoftoi se nga data 15 e këtij muaji fillon lëshimi i dokumentacionit të ri me kapacitete të dyfishuara, marrë parasysh kërkesat e larta për t'u pajisur me pasaporta, numri i të cilave nga 1 janari është rreth 124 mijë sosh.

Qeveria shkarkon bordin e drejtorëve të KRU "Hidroregjioni Jugor", emëron të përkohshmin

Prishtinë, 5 mars - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së martës ka shkarkuar bordin e drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidroregjioni Jugor" në Prizren.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se, bazuar në raportin vjetor për vitin 2022 dhe draft-raportin për vitin 2023, kjo ndërmarrje ka devijuar nga caqet e përcaktuara nga bordi i

drejtorëve në planin e biznesit. "Përveç devijimeve është evidentuar edhe mosinformimi dhe komunikimi jo i rregullt me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Në përgjithësi konsiderohet se bordi i drejtorëve nuk ka arritur të sigurojë planifikim efektiv dhe mbikëqyrje rigorozë të zbatimit të planit. Për këto arsye, rekomandojmë

shkarkimin e bordit të drejtorëve të emëruar më 10 gusht 2022", u shpreh Rizvanolli.

Kabineti qeveritar më pas miratoi kërkesën e Rivanollit për shkarkimin e bordit aktual të drejtorëve dhe emërimin e një bordi të përkohshëm me përbërje: Ismet Vrapqani - kryesues, Dhurata Gutaj - anëtare, Taulant Tanushaj - anëtar dhe Sibel Halkoshatri - anëtare.




Kosova hyn në tregun e "Një ditë përpara" në Bursën Shqiptare të Energjisë

PRISHTINË, 5 MARS - Bursa Shqiptare e Energjisë - ALPEX, e cila është bërë operationale në Shqipëri nga marsi i vitit 2023 dhe do të ndihmojë për një treg konkurrues në Shqipëri dhe Kosovë, për të gjetur energji elektrike me çmime më të favorshme. Në ceremoninë e mbajtur në Prishtinë kanë marrë pjesë kryeministri Albin Kurti, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, drejtoresha e Misionit të UASAIID-it në Kosovë, Eileen Devitt, drejtori i ALPEX-it, Sokol Dishnica dhe kryeshefi i KOSTT-it, Evetar Zeqiri. Me këtë rast, kryeministri Albin Kurti tha se inaugurimi i ALPEX-it shënon një moment historik për sektorin energjetik të Kosovës dhe përkushtimin tonë për bashkëpunim ekonomik me Republikën e Shqipërisë. "Në vitet

e fundit kriza energjetike e ka bërë një gjë të qartë, se sektori i energjisë, si në Evropë, ashtu edhe në gjithë botën, ka ndryshuar rrënjësisht. Thellimi i bashkëpunimeve ndërkufitare është një nga mënyrat më të suksesshme për t'u përballur me vështirësi, sfida dhe realitete të reja në këtë sektor", ka thënë Kurti, duke shtuar se vitet e fundit qytetarët dhe bizneset e Shqipërisë e kanë kaluar me energji të bollshme falë energjisë së deponuar nga Kosova, e dimrin sidomos këta të fundit qytetarët dhe bizneset e Kosovës e kanë kaluar më ngrohtë falë energjisë të marrë nga Shqipëria.

Ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, vlerësoi se sot, përderisa përurojmë ALPEX-in, rëndësia e kësaj burse dhe funksionimit të përbashkët të



tregut të energjisë elektrike është vështirë të përshkruhet me fjalë, sepse është shumëdimensionale, e ndikimet nuk janë vetëm të sotme, fuqinë e tyre do ta përjetojmë në vitet e dekadat që po vijnë.

Ndërsa drejtoresha e Misionit të UASAIID-it në Kosovë, Eileen Devitt, ka theksuar se është nder për të që të festojë bashkërisht këtë moment historik për sektorin e energjisë në Kosovë dhe i falënderoi të gjithë aktorët

për punën e bërë, Ministrinë e Ekonomisë, KOSTT-in, ZRRE-në dhe institucionet e tjera.

Kurse kryeshefi i KOSTT-it, Evetar Zeqiri, ka thënë se kjo platformë shënon një standard të ri të operimit në sektorin e energjisë, i cili do të garantojë më shumë transparencë dhe konkurrencë në tregun e energjisë elektrike si dhe do të ndikojë në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve ndërkufitare si dhe pritjet që çmimi i energjisë elektrike do të ulet për qytetarët e të dyja vendeve.

ALPEX-i është pjesë e reformës së ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës dhe ajo Shqipërisë për rindërtimin e sektorit të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin dhe politikat qeveritare për zhvillimin e këtij sektori.

Qeveria vendos masa të reja mbrojtëse për prodhimet e naftës

PRISHTINË, 5 MARS - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka njoftuar se nga monitorimi i rregullt i tregut të prodhimeve të naftës dhe bazuar në evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës ka evidentuar mospërshtatje të çmimeve vendore me lëvizjet e mëdha të çmimeve në tregun botëror, çka përbën bazë/shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse.

MINT ka njoftuar se me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit, mbrojtjes së konkurrencës dhe për t'i mënjeluar çrregullimet në treg,



MINT ka marrë vendim për caktimin e çmimit dhe masave të tjera mbrojtëse të prodhimeve të naftës.

Sipas këtij vendimi, marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është 2 euro centë për litër, kurse marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është 12 euro centë për litër.

Në komunikatë thuhet se llogaritja e marzhës tregtare maksimale e lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 4, paragrafi 1.1 dhe 1.2. të U/A nr. 03/2022 për Rregullimin e

Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse.

Është bërë me dije se ky vendim hyn në fuqi të martën dhe mbetet në fuqi 90 ditë.

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij vendimi bëhet nga Inspektorati Qendror i Tregut në bashkëpunim me Doganën dhe Administratën Tatimore. Me këtë rast, MINT ka njoftuar se Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut në ditët në vijim do ta shtojë mbikëqyrjen e tregut edhe sa i takon cilësisë dhe sasisë së prodhimeve të naftës.

Fondi i Kursimeve Pensionale: Në janar dhe shkurt kthimi bruto nga investimet arriti 49 milionë euro

PRISHTINË, 5 MARS - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK), në një njoftim për medie, ka njoftuar se ka vazhduar të ketë performancë pozitive investuese edhe për muajt janar dhe shkurt të këtij viti.

Në njoftimin e FKPK-së thuhet

se të dyja portfolet investuese kishin rezultat pozitiv dhe kthimi bruto nga investimet arriti në rreth 49 milionë euro. "Për këtë periudhë të raportimit, prej 1 janarit deri më 29 shkurt 2024, portofoli standard njohu ngritje të çmimit të njësisë prej 1.80 %,

që përkethehet në kthim bruto nga investimet rreth 48 milionë euro. Ndërsa portofoli konservativ kishte ngritje prej 0.58 % të çmimit të njësisë ose rreth 0.8 milionë euro kthim bruto nga investimet", bëhet me dije në njoftimin e Fondit të

Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Më tutje theksohet se historikisht, bashkë me rezultatit e këtij fillimviti, FKPK-ja i ka akumuluar afër 800 milionë euro kthim bruto nga investimet.



Në odën e Jasharëve, më 24 janar 1998: “Dihet se si na zë nata, por nuk dihet se si dhe a do të na çelë sabahi”!



Nga: Agim ZOGAJ, Besa ILAZI dhe Hazir REKA
(botuar në Javorën Politike Shqiptare “Zëri”, më 30 janar 1998)

Plaku e fillon rrëfimin e vet me fjalët: “S’po bahet, veç mos me metë gjallë hiq. Na askujt kurrë nuk i kemi ba, por na po i pengojmë dikujt vetëm se jemi gjallë ... Jemi në tokat tona, prej këtu s’kemi kah shkojmë. Po donë me na hjekë në mujshin, po ne nuk kemi ku me shku. Shka me bo. Druni s’po na shkoqet, zullumi s’po na hjeket. Dikush e ban, dikush s’mun e ban” – thotë mixha Shaban. Mëngjes i ftohtë ishte ai kur morëm rrugën për në Drenicë. Rrugëtimi deri në Skënderaj nuk pati asgjë të pazakonshme, nëse për një moment harrohet atmosfera e rëndë e cila pa sukses përpiquej të fshihej pas qetësisë së rrejshme. Dita e 24 janarit ishte dita e parë e të pamës në familjen e të vrarit Hysen Manxholli. Në Skënderaj autoblanda e policisë në qendër të qytezës dëshmonte për gjendjen e rëndë në këtë pjesë të Kosovës.

Në odën e jasharajve

“Ku është Prekazi i Poshtëm?” – pyetëm. “Në Drenicë, në zemër të Kosovës, në verilindje të

Skënderajt, vetëm dy kilometra larg prej këtu ...”, na tha shoqëruesi ynë i cili mendohej të na i sqaronte disa gjëra që nuk i dinim. Shumë shpejt u gjetëm para shtëpive të Jasharajve, e biseda na mbeti në gjysmë. Ky ishte Prekazi i Tahir Mehës, e tash ky është Prekazi i Shaban Jasharit, fshat jo i vogël që numëron rreth 400 shtëpi. Dyert e mëdha të shtëpisë së Jasharajve ishin skaj rrugës, e para tyre prisnin një grup djelmoshash të cilët i orientonin mysafirët. Drejt kësaj shtëpie mësynin nga të gjitha anët, shkonin për ta takuar mixhën Shaban, kryefamiljarin e shtëpisë, i cili dy ditë më parë ishte ballafaquar me policinë serbe. Na pranuan edhe neve në odën e Shaban Murat Jasharit, zotit të shtëpisë. Në odën e madhe, të mbushur përplot me bashkëfshatarë, miq, dashamirë e farefis të familjes Jashari, mixha Shaban qëndronte i ulur në krye të oxhakut. Oda do të ishte krejtësisht e zakonshme po të mos e kishte në ballë një flamur kombëtar të shtrirë të tërin në një anë të murit të odës dhe mbi të një mbishkrim i veçantë që thoshte: Mos e lejoni malin me dushk që t’ju ndryshkë allti e pushkë! “Ishe ba i fortë si graniti, o Shaban. Zoti ua pagoftë!” – i thoshin të afërmit. Disa e pyesnin: “A u mërзите, o Shaban

Murati?” “Jo, jo, aspak. Pse m’u mërzit?” – ua kthente plak. “Shaban Jashari” – foli një plak – “e mbrojti nderin e familjes së vet, e mbrojti ashtu si e mbron shqiptari pragun e shtëpisë”. “Si nuk mendohet kjo Serbi – tha dikush nga fundi i odës – kur një ditë mashtron duke thënë se u sulmua stacioni i policisë, e ditën tjetër thotë se shqiptarët u përleshën mes veti”. Shaban Jashari, 71-vjeçar, me urtinë e vet, më me dëshirë i dëgjonte mysafirët e odës, megjithatë, dikush i kërkoi që t’i thotë dy fjalë. “Nuk i kam shti mendët, thotë, se do të shpëtojë dikush nga familja ime atë mëngjes. Natën na e kishin këput rrymën e lidhjet telefonike. E, pastaj, krejtësisht tinza në pesë të mëngjesit na kishin sulmue nga të gjitha anët”. “Jo”, vazhdoi, “nuk kam ku të shkoj përtej pragut të shtëpisë sime. Do të vdesim të gjithë, i madh e i vogël në mbrojtje të dheut tonë, të nderit e të kombit. Do të vdesim të gjithë për një, se përtej vdekjes për vatan nuk kemi ku të shkojmë, ndryshe as zoti nuk na pranon”. Njerëzit hynin e dilnin në odën e Shabanit duke ia shtrënguar dorën e duke ia rrahur supet, me qindra pa pushuar tërë ditën. E, ai nuk lodhej, fliste. Mixha Shaban gjeti pak kohë edhe për ne, edhe pse u detyrua kështu t’i lërë mysafirët vetëm.

Sulmi i 22 janarit ndaj kësaj familje nuk ishte i pari. Kjo familje, e cila që kur dihet kishte pasur probleme me pushtetin serb, ka historinë e saj.

Tri lagje të një fshati të cilin e di tërë Kosova

Plaku e fillon rrëfimin e vet me fjalët: “S’po bahet, veç mos me metë gjallë hiq. Na askujt kurrë nuk i kemi ba, por na po i pengojmë dikujt vetëm se jemi gjallë ... Jemi në toka tona, prej këtu s’kemi kah shkojmë. Po donë me na hjekë në mujshin, po ne nuk kemi ku me shku. Përtej shtëpisë s’kemi ku me shku ...”. Fjalët e plakut ndërpreheshin nga krismat e tjegullave që binin nga kulmi e të cilat bashkëfshatarët vullnetarisht kishin ardhur për t’ia meremetuar shtëpinë e shkatërruar nga predhat dhe plumbat. “Ne jemi të Prekazit të Poshtëm, Prekazit të Tahir Mehës, është fshat prej tri lagjeve, që të gjithë jemi të një gjaku. Kanë qenë tre vëllezër, Jashari, Meha dhe Kadriu, e prej tyre janë krijuar tri lagjet e katundit: Lagjja Jasharaj, Mehaj dhe Kodrali. Lagjja Jasharaj jemi ne. Tre djem i kishte pasur Jashari. Familja ime është e të tretit djalë të Jasharit, e Muratit. Muratin e kishin pasë

thirrë atëherë për të shkuar ushtar për mbretin dhe prej atje nuk kthehet kurrë. Murati e kishte pasë lënë një djalë e një çikë. Çikën dy vjeç e djalin në djep. Djalin e Muratit, Fazliun, e rrit mixha, e marton dhe e ndan. Edhe Fazlia e len vetëm një djalë, Muratin. Ky është babai im. E unë i kam tre djem, Rifatin 50-vjeçar, Hamzën 47-vjeçar dhe Ademin 44-vjeçar. Tash, shyqyr Zotit, kam shumë nipa dhe mbesa, sepse vetëm ne Jasharët jemi një shtëpi, se ata të dy lagjeve tjera, Kodralitë dhe Mehajt, janë shtuar nga 30 shtëpi. Po tash jemi bërë 30 anëtarë të familjes. Rifati i ka tetë fëmijë, Hamza nëntë dhe Ademi pesë”, thotë plak. Familja e Jasharajve ka qenë e ndjekur që nga Lufta e Dytë Botërore. Gjatë luftës, Shaban Jashari iu bashkëngjit Shaban Polluzhës dhe me të ka qenë deri në fund. “Cili s’ka qenë atëherë në Drenicë luftëtar i Shaban Polluzhës. Më kujtohet se, pos me serbët, kemi pasur probleme edhe me vetë shqiptarët, me partizanët edhe me ata të Shqipërisë. Ka pasë ardhur këtu një brigadë nga Tropoja, e Mal Sadikut. Oda jonë u pat bërë konak dy ballistëve të një fshati afër, të Krushevcit. Kur merret vesh se po vjen brigada e Shqipërisë, mysafirët dalin prej shtëpie, sepse e dinin se nëse i zënë, do t’i pushkatonin

menjëherë. Vjen Mal Sadiku dhe e nxjerr babën dhe mua te gardhi për të na pushkatuar. Mirëpo, shpëtojmë kur një milic vullnetar që ishin atëherë garanton se ata dy nuk kanë dalë prej shtëpisë sonë dhe na lirojnë ...”!

Mësuesi i parë i fshatit

“Pas përfundimit të luftës kam shkuar ushtar prej vitit 1947 e deri në vitin 1949. Pas shërbimit ushtarak më kanë vendosur mësues dhe kam punuar katër vjet, prej vitit 1949 deri më 1952 nëpër fshatrat e Drenicës. Kam qenë mësuesi i parë në Prekaz. Kam punuar edhe në fshatrat tjera, në Terdevc, Lubovc. E kam pasur një certifikatë të nënshkruar prej Mehmet Gjevorit dhe Kolë Shirokës. Kam ditur shkrim-lexim shqip edhe para luftës. Pata mësuar te një hoxhë i Mitrovicës, në mejtep, tri vjet e edhe në Rezallë më ka mësuar një nxënës më i vjetër, Bajram Gashi, që e kemi pasur edhe nip tonin, prej abetareve të cilat atë kohë ishin të ndaluara. Për mësues u kualifikova në Gjakovë e në Prizren, ku mbajta kurse pedagogjike. Edhe certifikatën për mësues e kam të lëshuar në Prizren”. Mirëpo, Shabani si mësues punoi shumë pak, sepse pas katër vjetësh e largojnë si të “papërshtatshëm”. “Si u bë të më largojnë nga shkolla dhe të më burgosin? Dervish Kopriva, atë kohë, pra viteve të ‘50-ta, jetonte si kaçak maleve të Drenicës. Pat rënë në kontakt edhe me mua, më nderonte si mësues dhe si njeri autoritativ të asaj ane. Kur e zënë Dervishin, në një bllok të tij e gjejnë edhe emrin tim: kishte

dashur të më vendoste komesar politik. Kjo mjaftoi që të më marrin prej orës së mësimi e të më burgosin. Në burg më mbajtën 12 ditë. Babai me bollica më ka nxjerrë prej burgut sepse, si duket, shënimet për mua nuk kishin qenë shumë të rënda. Atëherë m’u hup e drejta e mësimi. Më thanë atëherë se mund të vazhdoj të punoj, por vetëm nëse punoj edhe për ta. Kishin nevojë për mësues të përshtatshëm që do ta vendosnin në zona malore në rreth të Gollakut e të Gjilanit. Më lusnin të shkoja duke më premtuar kushte më të mira, por nuk pranova dhe kurrë nuk jam penduar për këtë. Sot e asaj dite kam mbetur bujk, kurrë nuk jam marrë me punë të shtetit”. Prej atëherë, prej vitit 1952, kur edhe e patën përjashtuar Shabanin nga Lidhja Socialiste, familja e tij jetoi ashtu si mundi, kurrë pa iu ndarë zullumi e presioni. Iu thoshin ose bashkëpunoni, ose shpërnguluni! U patën lodhur një kohë dhe vendosën të shesin token dhe të shpërngulen diku tjetër jashtë Kosovës. Por, atë kohë nëna e Shabanit kishte ngulur këmbë dhe nuk i kishte lënë të shpërngulen. “E kemi pasur vështirë. Fëmijët kanë qenë të vegjël. Nuk kishim krah pune edhe pse tokë kishim mjaft, më shumë se 12 hektarë tokë pune. Ishte tjetër kohë atëherë. Kur e ke pasur hyqymetin kundra, e ke pasur edhe miletin kundra. Kemi qenë të leçitur, nuk u bë me na ardhë as miku, as nipi, as daja e as kojshia. Nuk e kemi pasur përkrahjen e askujt. Përkundrazi, janë munduar në të gjitha mënyrat të na thyejnë. Më

kujtohet se tatimi për familjen tonë ka qenë tepër i madh. Familja jonë dhe dy familje tjera patriotësh të fshatit, deri në vitin 1956 i kemi paguar tatim shtetit sa krejt Prekazi i Poshtëm. Por, kurrë nuk jemi ankuar, e besa edhe djemtë filluan të rriten. Djali i madh Rifati, në vitin 1969, shkoi në Gjermani për shkak të kushteve të rënda materiale. Ai nuk pati mundësi të shkollohet, vetëm filloren e kreu. Hamza dhe Ademi e kanë të kryer shkollën e mesme. Tash në Gjermani i kam edhe tre nipa, sepse të tre djemtë e kanë atje nga një djalë. Prej atëherë më nuk kemi pasur probleme ekonomike, vetëm aso me hyqmet, si familja e Shaban Jasharit, familje reaksionare na thonin”.

Ka pasur rrezik të shpërthimit të një lufte më të madhe

Djemtë e Shabanit, të flaktë për liri, kishin qenë aktivë gjatë të gjitha ngjarjeve, gjatë 1968-shit, 1981-shit e madje një prej organizatorëve të demonstratave të vitit 1989 në Skënderaj kishte qenë djali i vogël i Shabanit, Ademi. “E patën zënë atëherë në demonstrata Muratin, djalin e madh të Rifatit dhe, edhe pse 17-vjeçar, e dënuan me 45 ditë burg. Por, pasi ishte i mitur, e liruan pas 15 ditësh. Mirëpo, si duket, nuk u kënaqën me kaq dhe pas disa ditësh e sollën thirrjen se duhet t’i mbajë edhe 30 ditë. Djali nuk deshi më të shkojë, por u largua e shkoi në Gjermani dhe prej atëherë është atje. Djemtë atë kohë ishin aktivistë të LDK-së, por shumë shpejt hoqën dorë

prej saj ...” Kështu rrëfen mixha Shaban për jetën e tyre gjithmonë nën presion dhe me frikën se do t’i thërrasin, pasi plakun shpesh e thërrisnin në polici. Kishin vendosur të ndaheshin, sepse ishin bërë 30 anëtarë të familjes. “Shtëpitë i kishin përfunduar të tre djemtë dhe vetëm kishte mbetur që secili të dilte në shtëpinë e vet. Por, nuk na lanë vend, nuk doli ashtu s’i menduam, doli ndryshe, e tash them shqyrr që s’u ndamë, vetëm sa duhet të bashkohemi edhe më shumë”. “Në vitin 1991 na sulmuan. Edhe atëherë kemi qenë të rrethuar. Atë kohë kërkohej një grup të rinjsh të cilët, sipas policisë, ishin stërvitur në Shqipëri dhe kishin sjellë armatim prej atje. Erdhën për ta kërkuar atë natë më 30 dhjetor të vitit 1991 edhe djalin, Ademin. Atë kohë qëlloi në shtëpi edhe djali i madh Rifati, që kishte ardhur për pushime të Vitit të Ri. Lajmet për arrestimet dhe ndjekjet i dëgjua në radion e Zagrebit, sepse atë kohë vetëm ashtu mund të informoheshim. Në orën 5 e 15 të mëngjesit, forca të mëdha policore, me autoblanda e tanke na rrethuan. Atë natë bile Ademi mendonte të shkojë në Gjakovë për ta marrë një koftorr më të mirë. Por, mëngjesi na gjeti të rrethuar. Ademi pat qëlluar çuar dhe tha: ‘Pasha zotin, erdhën!’ Puna e parë që bëmë, iu thamë fëmijëve se nuk ka nevojë të tuten. Djemtë i morën armët dhe dolën. Dëgjoheshin vetëm të shtënat. Janë munduar të dalin prej lëme, për të depërtuar rrethin, por ishte qitur rrethi. U zatetën fyt për fyt. Ata bam, këta bam. U munduan të dalin nga ana tjetër. Pas nja 30

minutash u qetësuan të shtënat. U mërzita fort, s’ka çare pa u mërzitur njeri. Mendova: m’i vranë djemtë. Por ata e kishin shpërthyer rrethimin dhe kishin kaluar në mal – në malin tonë i cili është nja 200 metra larg shtëpisë. Të shtënat filluan të ndihen përsëri, tash vinin prej shpatit dhe prapë u dhez lufta. Lufta atë ditë ka vazhduar deri në orën gjashtë të mbrëmjes. Atë ditë thuhet se kanë qenë qindra vetë me pushkë, filluan të vijnë prej të gjitha anëve të Kosovës. Policët erdhën edhe me helikoptera. Atëherë ka qenë rreziku i shpërthimit të një lufte më të madhe. Por patën ardhur shumë vetë për të ndërmjetësuar te ne dhe te policia. Vetëm Fehmi Aganin e pranuan për të biseduar dhe për t’i bindur që ta ndërprejnë luftën. Në mbrëmje u qetësua, u tërhoqën policia”.

Prej vitit 1991, djemtë në arrati

Kështu rrëfen plaku për atë që ka ndodhur atë ditë me bijtë e tij që patën dalë në mal, mirëpo brenda shtëpisë u pat zhvilluar një luftë krejt tjetër. “Na patën hyrë edhe brenda në shtëpi aty kah ora 11. Unë pata dalë jashtë dhe si më panë menjëherë më sulmuan, më ranë kamxhik e më përgjakën. Secili që dilte prej shtëpisë e zinin. E zunë edhe djalin e Ademit, djalin 16-vjeçar të Hamzës, e madje edhe djalin 8-vjeçar të vajzës sime, e cila kishte qëlluar te ne. Të gjithë i kanë rrahur. Na lidhën te trafoja dhe ashtu na mbajtën disa orë. Na kërcënonin. Më thonin se t’i kemi vrarë djemtë. Pas një kohe u dëgjua edhe altoparlanti





që thonte: ‘Ademe, predaj se! Unishtiqemo t’i kuqu, ubiqemo ti oca!’ Ata mendonin se Ademi është brenda në shtëpi dhe paramendonie këtë: një herë na kishin sulmuar e gjuajtur me plumba – me orë të tëra e pastaj, pasi nuk patën ndonjë sukses, e kërkonin Ademin të dorëzohej. Nuk e dinin se djemtë kishin dalë në mal. Donin të hynin brenda në shtëpi për të kontrolluar, sepse ende mendonin se djemtë i kam aty. Pas një kohe më morën. Më qitën para tytës së pushkës dhe më detyruan të eci i pari. Por, si duket, nuk u mjaftova vetëm unë, sepse e morën edhe vajzën time shtatzënë edhe Ilirianën e cila ishte krejt e re atëherë dhe na detyruan të hyjmë në shtëpi. Kur e panë se djemtë e mi nuk janë në shtëpi, më morën dhe më çuan në Mitrovicë – në stacionin e policisë, ku më mbajtën deri të nesërmen. Gjatë tërë kohës më kanë provokuar. ‘Ta kemi vrrarë Ademin e Rifati është i plagosur rëndë ...’ – më thonin. Prej dajakut të madh më kanë lënë edhe me pasoja. Prej atëherë më nuk dëgjoj mirë. Zoti deshi të më shpëtojnë djemtë, por ata prej asaj kohe janë në arrati. Mendonim se kjo situatë nuk do të zgjasë shumë, por u bë kohë e gjatë dhe asgjë nuk ndryshoi. S’kam qejf t’ia mohoj punën askujt, por u bënë tetë vjet e politika e Rugovës s’po fiton, burrë. Çka me bo. Druni s’po na shkoqet, zullumi s’po na hjeket. Dikush e ban, dikush s’mun e ban”, thotë mixha Shaban. Ky është rrëfimi i vitit 1991, por familja e Shaban Jasharit kurrë nuk u la e qetë. “Kur më patën thirrë në vitin 1992 për të më pyetur për rastin e 1991, pata kërkuar nëpërmjet

avokatëve për të nxjerrë aktakuzën se për çka na akuzuan atëherë. Asgjë nuk më dhanë, nuk kishin asgjë. Vetëm se na patën dërguar një ftesë sipas të cilës duhej për t’u lajmëruar në gjyq, e ftesa ishte për ‘Okrivljenog Rifata Jasharija i ostale’, asgjë më shumë nuk shkruante në të.

“Kam boll lula tjera në shtëpi”

Kjo familje edhe gjatë vitit 1993 pati një “vurmak” të madh. Familja Jasharaj u ballafaqua me diçka tepër të rëndë, u detyruan ta lërë peng djalin e Ademit. Kështu, një ditë, rrugës për në shtëpi e zunë Lulzimën, djalin e madh të Ademit, së bashku me gruan e Rifatit dhe një djalë (6-vjeçar) të tij. Lulin e kishin marrë dhe e kishin çuar në Mitrovicë në polici, ku e kishin maltretuar dhe ushtruar presion në të. I kanë kërkuar armë sepse, për ndryshe, nuk do ta lironin. Për këtë mixha Shaban thotë: “Tri ditë e kanë mbajtur djalin, e neve gjatë asaj kohe na kanë maltretuar me telefon. Na thirrnin tërë natën, duke më thënë mua: ‘Po t’kërkon Luli’. Djalin e lamë peng. Më thonin ‘eja merre djalin’, por unë u thashë se nuk vie. Më thanë se e dimë se i ke djemtë aty, pra nëse don me e pa gjallë Lulin, atëherë le të dorëzohen djemtë dhe le t’i dorëzojmë armët. Por, unë iu thashë: ‘Nëse doni, ejani e merrini, sepse ju i keni përzënë djemtë e mi prej shtëpie me pushkë, e vallahi tash me top nuk mund t’i qitni prej saj’. Iu thashë: ‘Nëse doni ejani, e sa për Lulin, bëni çfarë të doni me të, se kam boll lula tjerë’. Qëllimi i tyre ka

qenë se ja tash ia morëm djalin e madh Ademit dhe, menduan, thehet familja. Por, ne këtë s’e pranuan, të gjallë më nuk do t’u dorëzohemi. Tri ditë rresht na kanë bërë person me telefon. Edhe njerëz kanë tentuar të na çojnë, por askush nuk ka pranuar të vij. Ne nuk shkuam e ata nuk guxuan të vijnë. Më në fund marrin vendim për të liru djalin. E kishin rrahur goxha fort. Me këmbë e duar të ënjta ka ardhur në shtëpi. I kishin dhënë afat që brenda 40 minutave të kthehet, por më nuk e kemi lënë të shkojë. Me kaq pat përfunduar puna e tyre njëherë përnjëherë edhe pse presioni psikik ka qenë i padurueshëm gjatë tërë kohës”, thotë Shaban Jashari. Prej atëherë për këtë familje më nuk pat qetësi. A mund të ketë qetësi e rehati për ata që jetojnë gjithmonë në pritje të mysafirëve të paftuar, të cilët nuk dihet se kur mund t’ia behin. Hallet e kësaj familjeje shtohen edhe më shumë pas gjykimeve ku në mesin e 15 të akuzuarve të cilët i dënojnë me 264 vjet burgim, vitin e kaluar në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, ishte edhe Ademi, të cilin e dënuan me 20 vjet burgim në mungesë. Atëherë u dënua edhe Asllan Selimi me 15 vjet burg e që është i fejuari i Ilirianës së plagosur.

Historia përsëritet

“Tash vjen edhe rasti i fundit edhe pse ka një vit që na përcjellin shtëpinë pandërprerë. Na përcjellnin me dylbi prej fabrikës së municionit e cila ja ku shihet s’i ka as 300 metra prej shtëpisë sonë. Nuk di që ka diku në botë ligj që lejon për të përcjellë gjatë tërë kohës brenda në shtëpinë

tënde. Gjithmonë nuk mund të jetohej nën vështrimin e tjetrit, por s’kishim se si fsheheshim se na shikonin si në pëllëmbë dore”. Më 21 janar Prekazi i Poshtëm mbetet pa rrymë, e që nga ora gjashtë e mbrëmjes edhe pa telefon. Shabani atë natë ishte burri i vetëm i kësaj familjeje. “Jemi çuar në syfy, e kam pasur edhe një mik të vjetër, nipin 76-vjeçar Bajram Gashin. Kur u bë ora 5 e 17 erdh koha me e lanë syfyryn, nisa me e falë sabahin, veç kur t’u ni një gjëzim dimbau. Ka qenë gjuajtje e largët, predhë. Tri të tilla janë gjuajtur mbi shtëpinë time. Një ka rënë në ahër, një në derë e tjetra diku në oborr”. Por, familjen e Jasharajve nuk e habitën as predhat e as gjëmimet e murtajave. Ishin mësuar më me këso sulme. Të gjithë kishin rënë për tokë dhe asnjë zë nuk ishte ndier. As atëherë kur plumbi e kishte marrë Selveten, bijën e madhe të Hamzës e as atëherë kur Iliriana ishte plagosur. E dinin se historia po përsëritet, edhe pse me asgjë nuk i kishin provokuar e dinin se kurrë nuk do t’i linin të qetë. I kishin sulmuar. Të gjithë pos plakut ishin gjetur në dhomën e gjyshes, mbesës së Shaban Polluzhës. Nuk ua kishte marrë mendja se policia kanë guxim të futen në oborr. “Edhe pse dy vajzat ishin plagosur, askush nuk bëri as ciu. Ma mori mendja se donë për të na rrëzuar krejt shtëpinë. Dridhje të mëdha ka pasur, tërë xhamat janë thyer. Është ndier edhe një zë i thekshëm në serbishte që thonte: ‘Ugjite, ugjite, ugjite!’ Më dukej se po qesin edhe prej malit. Pastaj u dëgjuan bombat e dorës, edhe

murtajat janë përdorur, kanë mbetur gropa nëpër tërë oborrin. Katin më të lartë të shtëpisë e kanë bërë shoshë. Plumbat i gjen gjithkrah nëpër shtëpi – në dyer, dritare, mure. Ka plumba që i kanë shpuar tej e përtej edhe katër parë dyer”, thotë plaku. Kur ia thejnë derën e hymjes për në odë, me gjuajtje të rënda dhe kur tentojnë të hyjnë brenda, plaku s’durohet dhe mbrohet. “Më vloi gjaku. Iu thashë ku po doni, bre t’hyni?! Po a e dini se këtu veç fëmijë ka”? Sulmi kishte zgjatur rreth 30 minuta, pastaj forcat policore ishin tërhequr. “Shkova te familja. ‘A shpëtua?’ – iu thashë. “‘Po, po, veç Selveten pak e ka marrë plumbi”. “Hajr i koftë, po ka mundur të na marrë të gjithëve” – iu thashë. “Kur e pashë se vajzat nuk ishin në rrezik jete, m’u lehtësua shpirti. Vendosëm që sa më shpejt që është e mundshme t’i largojmë prej shtëpisë, sepse kemi pritur se do të vijnë prapë me forca të tjera. Sa ka zgjatur sulmi, pas pesë minutave kanë ardhur bashkëfshatarët nga të gjitha anët ... Tash presim”. Këtu e përfundon këtë rrëfim të tmerrshëm mixha Shaban, e shpresojmë që ky të jetë rrëfimi i tij i fundit për ngjarje të tilla të rënda për familjen e tij. Pasdite, para perëndimit të diellit, ne e lëshuam odën e ngrohtë të Shaban Jasharit, e cila frymonte optimizëm, me një ndjenjë të një sigurie të çuditshme, në shtëpinë që, sipas dukjes së jashtme, me përplot plumba e vrima, do të duhej të ishte vendi më i pasigurt në Kosovë. /Telegrafi/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Kuvend
 Servisim
 Pajisje



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Sot zhvillohen dy ndeshje në çerekfinale të Kupës

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Dy ndeshje të fazës së çerekfinale të Kupës së Kosovës në futboll do të zhvillohen sot (e mërkurë) dhe dy ndeshje të tjera do të zhvillohen nesër (e enjte). Në

stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan, Prishtina nga ora 13:00 e pret skuadrën e Trepçës ’89. Synim i kryeqytetasve është kualifikimi në fazën gjysmëfinale e më pas

rrugëtimi drejt triumfit në këtë garë ashtu sikurse në edicionin e kaluar. Edhe skuadra mitrovicase do t’i provojë shanset e saj. Ndërsa në stadiumin “18 Qershori” do të përballen Dukagjini dhe

Drita. Një përballje mjaft e fortë mes dy skuadrave elitare që kërkojnë sukses edhe në garën e Kupës. Të enjten Vjosa do të përballlet me skuadrën e Suharekës, kurse Malisheva e pret Ballkanin.



Sonte dy përballje në Superligë, vëmendja te Prishtina - Trepça

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 5 MARS - Xhiroja e 23-të në Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll do të sjellë ndeshje shumë interesante dhe do të zhvillohet sot (e mërkurë) dhe nesër (e enjte). Ndeshja kryesore për këtë xhiro është ajo mes dy skuadrave rivale, Sigal Prishtinës dhe Trepçës. “Xehetarët” janë liderë me 20 fitore e dy humbje, derisa “bardhekaltrit” renditen në vendin e tretë me 14 fitore e tetë humbje. Mitrovicasit kanë një bilanc pozitiv në përballjet e fundit me kryeqytetasit ku kanë fituar tri përballjet e fundit, derisa të dy këto klube kanë synim titullin e kampionit. Kjo ndeshje zhvillohet nga ora 19:00, derisa në kohë të njëjtë zhvillohet dhe përballja tjetër mes Pejës dhe Proton Cable Prizreni. Pejanët janë në vendin e dytë me 16 fitore e gjashtë humbje, kurse

prizrenasit renditen në vendin e shtatë me shtatë fitore e 15 humbje. Të enjten Istogu do të luajë ndaj Golden Eagle Yllit, ku therandasit janë favoritë absolutë pasi Istogu po paraqitet vetëm me basketbollistë vendorë. Istogasit kanë vetëm një fitore e 21 humbje, derisa Ylli numëron 13 fitore e nëntë humbje. Përballja në mes të Vëllaznimit dhe Bashkimit e mbyll këtë xhiro dhe zhvillohet nga ora 19:00 në Gjakovë. “Kuqezinjtë” janë në vendin e pestë me nëntë fitore e 13 humbje, kurse prizrenasit në vendin e gjashtë me tetë fitore e 14 humbje.

PRINCE CAFFE SUPERLIGA-JAVA 23

Të mërkurën takohen:
 19:00 Peja - Proton Cable Prizreni
 19:00 Sigal Prishtina - Trepça

Të enjten takohen:
 17:00 Istogu - Golden Eagle Ylli
 19:00 Vëllaznimi - Bashkimi



Kosova mëson kundërshtarët për kualifikimet ‘Euro 2025’

PRISHTINË, 5 MARS (ER) - Në selinë e UEFA-s në Nion të martën është bërë tërheqja e shortit për fazën e parë kualifikuese për Kampionatin Evropian 2025 në konkurrencën e femrave. Kjo fazë kualifikuese sivjet zhvillohet në tri liga. Kosova bën pjesë në Ligën B dhe në bazë të shortit është

përfshirë në Grupin B4, ku janë edhe Uells, Kroacia dhe Ukraina. Kualifikimet nisin në muajin 3 prill, derisa në Evropian kualifikohen vetëm nga dy përfaqësueset prej katër grupeve të Ligës A, derisa vendet e tjera plotësohen përmes “play-off”-it. Nga Liga B, ku bën pjesë edhe Kosova, tri

përfaqësueset e para në secilin grup kalojnë në “play-off”, ku përcaktohen shtatë përfaqësueset e fundit që kualifikohen në Evropian. Përfaqësuesja e Kosovës ka një seri prej 14 ndeshjeve pa humbje dhe nën drejtimin e Anneli Andersen ka treguar formë shumë të mirë.

Sadiku triumfon në betejën e parë në turneun botëror të boksit

PRISHTINË, 5 MARS - Donjeta Sadiku e ka nisur me fitore turneun kualifikues botëror të boksit për Lojërat Olimpike “Paris 2024”, që po mbahet në Busto Arsizio të Italisë. Boksierja e Kosovës mundi Shona Whitwell të Britanisë së Madhe, me vendim unanim të gjyqtarëve. Për ta fituar

normën olimpike, Sadikut i duhen edhe tri fitore. Vetëm tri vendet e para në kategorinë e saj (-60 kg) marrin biletën për Paris 2024. Donjeta të tre raundet boksoi për mrekulli dhe dominoi në ring gjatë tërë kohës duke i dhënë kundërshtares goditje të forta dhe precize. Trajnerja

e saj, Marjola Sallauka, është shprehur e kënaqur me boksingun që tregoi Donjeta në rrugën për ta fituar normën Olimpikë “Paris 2024”. Të dielën ka garuar Bashkim Bajoku (-51 kg), i cili pësoi humbje në rrethin e parë. Të enjten në ring ngjitet edhe Shpëtim Bajoku (-63.5 kg).



Miqësorja e fundit para 'Euro 2024', Shqipëria përballlet me Azerbajxhanin

TIRANË, 5 MARS - Federata Shqiptare e Futbollit ka gjetur gjuhën e përbashkët me Federatën e Azerbajxhanit për të zhvilluar një tjetër miqësore në muajin qershor, para nisjes së Kampionatit Evropian "Gjermani 2024".

Miqësorja me Azerbajxhanin

do të luhet më 7 qershor, ndërkohë mbetet për t'u përcaktuar orari dhe stadiumi ku do të luhet kjo sfidë. Kjo do të jetë ndeshja e gjashtë në histori mes dy skuadrave, teksa Shqipëria numëron tri fitore, një barazim dhe një humbje kundër Azerbajxhanit.

Kombëtarja shqiptare fillimisht do të luajë dy takime miqësore në muajin mars. Kuqezinjtë do të përballen me Kilin më 22 mars në stadiumin "Ennio Tardini" në Parma të Italisë, duke nisur nga ora 20:45. Tri ditë më vonë, më 25 mars, Kombëtarja

do të luajë me Suedinë në stadiumin "Friends Arena" të Stokholmit. Në muajin qershor Shqipëria do të zhvillojë edhe dy ndeshje të tjera miqësore. E para me Lihtenshtejnin më 3 qershor, ndërsa takimi i fundit miqësor para nisjes së Evropianit do të



jetë ndaj Azerbajxhanit më 7 qershor.

Leverkuseni 10 pikë para Bayernit, Xhaka: Asgjë nuk ka përfunduar

LEVERKUSEN, 5 MARS - Granit Xhaka nuk merr asgjë si të mirëqenë pas përvojës së tij me Arsenalin pavarësisht prej epërsisë prej 10 pikësh te Bayer Leverkuseni në krye të Bundesligës. Xhaka ka luajtur një rol kyç në ecurinë e jashtëzakonshme të pamposhtur të Leverkusenit drejt titullit. Leverkuseni ka krijuar distancë prej 10 pikësh, por mesfushori zviceran është i kujdesshëm dhe i frikësohet ndonjë kapitullimi, një fat që ai pati sezonin e kaluar me Arsenalin, pasi "Topçinjtë" ia dorëzuan Manchester Cityt titullin e kampionit. "Ne duhet të jemi krenarë për pozicionin tonë, por asgjë nuk është fituar ende, po flas nga përvoja ime e sezonit të kaluar në Arsenal. Ne kishim një avantazh të ngjashëm me pikët ndaj ekipit të dytë dhe ne nuk e fituam ligën, kështu që unë e di këtë përvojë dhe e kam ndarë me dhomën e zhveshjes. Dhjetë pikë janë shumë kur të mbeten 10 ndeshje, por kanë mbetur edhe 30 pikë të marrë kështu që nuk ka mbaruar", ka thënë Xhaka.



Arsenali kishte tetë pikë epërsi ndaj Cityt në një fazë në sezonin 2022-2023, përpara një kolapsi në fund të sezonit. "Topçinjtë" ishin në krye të tabelës për 248 ditë gjatë sezonit. Jo befasisht, Xhaka do të jetë i etur

për të shmangur një përsëritje të tillë. Me fitoren ndaj Kolnit, Leverkuseni rriti epërsinë në renditje në 10 pikë, pasi Bayerni u ndal me barazim nga Freiburgu të premten mbrëma.

Lakersat mposhtin kryesuesit, Milwaukee 'leksion' clippersave

LOS ANXHELOS, 5 MARS - Ekipi i Minnesotas ka marrë kreun e renditjes në Konferencën e Perëndimit pas fitores me rezultat 119-114 ndaj Portlandit. Gjashtë lojtarë të skuadrës vendase realizuan mbi 10 pikë, ku u dallua Gobert, autor i 25 pikëve e 16 reboundeve. Lakersat mundën me rezultat 116-104 Oklahomën, që lëshon kreun në Perëndim. Russell me 26 pikë e Davis me 24 pikë e 12 rebounde ishin më të mirët për lakersat, ndërsa për miqtë mungoi lojtari lider. Nuk zhgënjën Milwaukee, që mposhti me rezultat 113-106 clippersat dhe ngjitet në



vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. George e Hardeni realizuan nga 29 pikë secili për clippersat, por

që mbeten për statistikë. Lillardi me 41 pikë bëri dallimin në fushë për Bucksin.

REZULTATET

Brooklyn - Memphis	102-106
Milwaukee - Clippers	113-106
Minnesota - Portland	119-114
Utah Jazz - Washington	127-115
Sacramento - Chicago	109-113
Lakers - Oklahoma	116-104

SHKURT

U mbajt seminari me trajnerët e Superligës dhe Ligës së Parë

Shoqata e Trajnerëve të Futbollit, në bashkëpunim me Federatën e Futbollit të Kosovës, organizoi seminarin njëditor për trajnerët e klubeve të Albi Mall Superligës dhe klubeve të Raiffeisen Ligës së Parë. Trajneri i njohur Astrit Maçi ka ligjëruar mbi temën e përgatitjes fizike të futbollistëve, duke theksuar aspektet e rëndësishme të trajnimit me dhe pa top. Krahas seancës teorike e cila u mbajt në selinë e FFK-së, ky seminar pati edhe pjesën praktike, e cila u zhvillua në Kampin Nacional në Hajvali. Seminari ka ofruar një platformë të gjerë për trajnerët për të shkëmbyer njohuri dhe për t'i përmirësuar aftësitë e tyre për përgatitjen e futbollistëve.

Inzaghi falënderon publikisht Asllanin: Është një shembull i shkëlqyer

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, e ka lavdëruar publikisht mesfushorin shqiptar Kristjan Asllani pas fitores ndaj Genoas (2-1). Asllani ka shënuar golin e parë në këtë ndeshje. "Duhet ta lavdërojmë Asllanin, pasi ai pati tri ndeshje në javë dhe ka qenë kaq i çmuar për ne, duke u stërvitur në maksimumin e tij, edhe kur nuk luajti aq shumë. Unë dua ta lavdëroj publikisht Krisjanin. Ne kemi nevojë për të gjithë këtë sezon dhe ai është një shembull i shkëlqyer për këtë", ka thënë Inzaghi.

Verstappeni mund të kalojë te Mercedesi

Mund të duket si fantazi për momentin, por Formula 1 na ka mësuar se nuk ka asgjë të pamundur. Max Verstappeni, tri herë kampion i botës, mund të lërë Red Bull Racing për të garuar me Mercedesin vitin tjetër. Ai do ta zërë vendin e lënë bosh nga Lewis Hamiltoni, që do të garojë me Ferrarin nga viti 2025. Kjo është një hipotezë hedhur nga mediet britanike dhe që po bën xhiron e botës, duke parë se janë të shumtë ata që kërkojnë "kokën" e Hornerit. Gjithsesi, mbetet për t'u parë edhe mendimi i drejtuesve të Formulës 1, që për momentin kanë heshtur.

Guardiola kërkon kujdes ndaj Kopenhagenit: Mjafton një episod që të përmbysët gjithçka

Skuadra e Manchester Cityt rikthehet të luajë në Ligën e Kampionëve. Skuadra e Pep Guardiolas do të jetë sërish në fushë të mërkurën në mbrëmje, në ndeshjen e dytë të fazës së 16-të kundër Kopenhagenit. Në ndeshjen e parë "citizens" fitoi në Danimarkë me rezultatin 3-1, duke siguruar efektivisht kalimin në turin tjetër. Megjithatë, trajneri spanjoll nuk i beson atij rezultati dhe kërkon nga të tijtë ta japin maksimumin në fushë. "E di që rezultati 3-1 ndaj Kopenhagenit është një rezultat i mirë, por në fazën e grupeve bëmë të njëjtën gjë me Leipzigun. Më pas, në ndeshjen e dytë, ishim në disavantazh 0-2", ka thënë Guardiola.

Pochettino rezikon shkarkimin, Chelsea identifikon dy trajnerë

Mediet britanike konfirmojnë se drejtuesit e Chelseat do ta rishikojnë pozicionin e trajnerit Mauricio Pochettino në fund të

sezonit. Madje klubi është duke punuar për të gjetur edhe një zëvendësues të mundshëm për të ardhmen. Sezioni i vështirë i "bluve"

të Londrës vijoi edhe fundjavën e kaluar, kur ata barazuan ndaj Brentfordit në fundin e lojës. Chelsea mbetet në gjysmën e dytë

të tabelës së renditjes së Premierë Ligës. Klubi do ta presë deri në fund të sezonit pronarin Todd Boehly për të vendosur për të ardhmen e

Pochettinos. Gjithsesi, klubi ka lëvizur herët dhe dy emra janë në listë: Ruben Amorim i Sportingut dhe Roberto De Zerbi i Brightonit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

**DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN
BELEDIJE EĞİTİM MÜDÜRLÜĞÜ, PRIZREN**

Nr. 506/24
Tarih: 05.03.2024

Kosova Cumhuriyeti 03/L-212 sayılı "Çalışma Yasasının - İş Kanununun" 8. maddesi, Kosova Cumhuriyeti 03/L-068 sayılı "Belediyeler Eğitim Kanunu'nun" 5. maddesinin (c) bendi, Kosova Cumhuriyeti'nde Üniversite Öncesi Eğitim için 04/L-032 Sayılı Kanunun 35. Maddesi, kamu sektöründe iş ilişkisi kurulmasına ilişkin usullerin düzenlenmesi 07/2017 sayılı İdari Talimatı, KEBTB Genel eğitimin mesleki çerçevesine ilişkin normatif için 05/2021 sayılı İdari Talimatı, KEBTB Mesleki (Branş) öğretmenlerinin çalışma normu düzenlediği 05/2015 sayılı İdari Talimatı, KEBTB 01/2022 sayılı İdari Talimatı baz alınarak, Prizren Belediyesi Eğitim Müdürlüğü şunu duyurmaktadır:

UYGUN ÇALIŞMA YERLERİ İÇİN İŞ İLANI DUYURUSU (Belirtilmemiş Süre)

Belirtilen çalışma pozisyonu: Coğrafya Dersi Öğretmeni
Pozisyon: 1

Okul:
"Motrat Qiriazî" İlk ve orta alt öğretim okulu

İstenilen Kalifiye:

- Mastır Eğitim Seviyesi - Eğitim Fakültesi (300 ECTS - Kredi)
- Dört yıllık eğitim sistemi
- Baçelor (Dört yıllık - 240 ECTS - Kredi)

UYGUN ÇALIŞMA YERLERİ İÇİN İŞ İLANI DUYURUSU (Belirtilmiş Süre)

Belirtilen Çalışma Pozisyonu: Fizik - Kimya Dersi Öğretmeni -
Pozisyon: 1

Okul:
"Motrat Qiriazî" İlk ve orta alt öğretim okulu
(Belirtilmiş Çalışma süresi, mevcut öğretmenin başka bir kurumda görev süresi bitene kadar) - 10 Ders Çalışma saati için (Yarım çalışma normu)

İstenilen Kalifiye:

- Mastır Eğitim Seviyesi - Eğitim Fakültesi (300 ECTS - Kredi)
- Dört yıllık eğitim sistemi
- Baçelor (Dört yıllık - 240 ECTS - Kredi)

Belirtilen Çalışma Pozisyonu: Sınıf Öğretmeni
Pozisyon: 1

Okul:
"Nazim Kokolari - Budakova" İlk ve orta alt öğretim okulu - Dardania
(Çalışma süresi 01.04.2024 - 01.04.2025, mevcut öğretmen doğum izninden dönene kadar)

İstenilen Kalifiye:

- Eğitim Fakültesi - Sınıf Öğretmenliği Bölümü Mezunu
- Öğretmenlik Fakültesi
- Görev ve Sorumlulukları:**
- Branşına göre günlük, haftalık, aylık ve yıllık eğitim-öğretim çalışma planını hazırlayacaktır,
- Dersi önceden belirlenmiş zaman göre işler,
- Her öğrencinin başarısını ve gelişimini planlar, gözetler, değerlendirir ve yönlendirir,
- Yeni öğretim ve değerlendirme metodolojilerini uygular,
- Mesleki gelişim eğitim seminerlerini önemser ve takip eder,
- Okul yönetiminin gereksinimlerine göre çalışmalarını koordine eder,
- Ders dışı etkinlikler düzenler,
- Okulun bütün faaliyetlerine katılım sağlar,
- Okul yönetiminin talep ve gereksinimlerine göre rapor hazırlar,
- Okulun öğrencileri, ebeveynler, meslektaşları ve okul yönetimi ile iletişim kurar ve işbirliği yapar,
- Okulun tüm organları, okulun düzenlediği tüm organizasyonlar ve ders dışı etkinliklerinde aktif olması gerekir,
- Yürürlükteki mevzuata, Yönetmeliklere ve İdari Talimat göre kuralların belirlediği okul müdürü tarafından verilen diğer faaliyet ve işleri de yapar,

İstenilen Evraklar:

- Kimlik fotokopisi
- Üniversite Diploması (Noter tasdikli kopyası)
- Denklik, aday ülke dışında mezun olduysa
